



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:118906

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06186129

KPPP.nr. 571/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit “Astronik” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810824145 dhe seli në Prishtinë, rr. “Shpëtim Robaj”, p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sabri Ademi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Selmans Network” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810815061 dhe seli në Prishtinë, rr. “Jakov Xoxa”, Kompleksi Blini, Co, p.n., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 354/22 i datës 26.05.2022, të lejuar nga Përbaruesi Privat Ilir Mulhaxha nga Prishtina, jashtë seancës me datën 20.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Selmans Network” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 354/22 i datës 26.05.2022, i lejuar nga Përbaruesi Privat Ilir Mulhaxha, MBETET NË FUQI.
- II. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej EUR 78.00 (shtatëdhjetë e tetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Astronik” Sh.P.K., me datë 26.05.2022 ka lëshuar urdhrin P.nr. 354/22, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumenteve: Faturës nr. 1559/19, e datës 05.12.2019; Faturës nr. 46/20, e datës 14.01.2020; Faturës nr. 104/20, e datës 30.01.2020; Faturës nr. 378/20, e datës 13.03.2020; Faturës nr. 382/20, e datës 14.03.2020; Faturës nr. 997/20, e datës 11.08.2020; Faturës nr. 1004/20, e datës 13.08.2020; Faturës nr. 1316/20, e datës 06.10.2020; Faturës nr. 1327/20, e datës 07.10.2020; Faturës nr.

1408/20, e datës 27.10.2020; Faturës nr. 1477/20, e datës 03.11.2020; Faturës nr. 19/21, e datës 07.01.2021; Faturës nr. 128/21, e datës 23.01.2021; Faturës nr. 837/21, e datës 24.05.2021; Faturës nr. 1100/21, e datës 02.07.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin “Selmans Network” Sh.P.K., që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,251.00 EUR (një mijë e dyqind e pesëdhjetë e një euro) me kamatë ligjore prej 8 % duke llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbare.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përmbare, me arsyetimin se dokumentet në bazë të cilave është lejuar urdhri përmbare nuk i plotësojnë kushtet ligjore sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së, duke mos pasur dëshmi të dorëzimit të faturave dhe as nuk ka dëshmi se janë realizuar punët sipas faturave. Më tej, ka theksuar se faturat nuk janë pranuar nga debitori, andaj të njëjtat nuk kanë tiparet e përmbareshmërisë dhe cilësinë e dokumenteve të besueshme sipas LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbare të anulohet, si dhe të obligohet kreditori që t’i paguajë shpenzimet e procedurës përmbare në shumë prej 162.25 EUR.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetimin se i njëjti nuk është paraqitur për asnjërën nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet prapësimi sipas nenit 71 të LPP-së. Ka shtuar se faturat në bazë të cilave është lejuar urdhri përmbare janë pranuar nga debitori dhe nuk janë kundërshtuar nga i njëjti. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbare të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimi, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbare, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbaremi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbare po qe se në të është

*treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.*

Gjykata në rastin konkret vlerëson se dokumentet: Fatura nr. 1559/19, e datës 05.12.2019; Fatura nr. 46/20, e datës 14.01.2020; Fatura nr. 104/20, e datës 30.01.2020; Fatura nr. 378/20, e datës 13.03.2020; Fatura nr. 382/20, e datës 14.03.2020; Fatura nr. 997/20, e datës 11.08.2020; Fatura nr. 1004/20, e datës 13.08.2020; Fatura nr. 1316/20, e datës 06.10.2020; Fatura nr. 1327/20, e datës 07.10.2020; Fatura nr. 1408/20, e datës 27.10.2020; Fatura nr. 1477/20, e datës 03.11.2020; Fatura nr. 19/21, e datës 07.01.2021; Fatura nr. 128/21, e datës 23.01.2021; Fatura nr. 837/21, e datës 24.05.2021; Fatura nr. 1100/21, e datës 02.07.2021, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit tek pranuesi i secilës faturë. Ndërsa këto fatura i janë bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit pasi që janë të përshtatshme për përmbarim.

Pretendimet e debitorit se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbarimor nuk janë të përshtatshme për përmbarim gjykata i vlerësoi si të paqëndrueshme pasi që debitori, nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69, par.4 të LPP-së për të vërtetuar ekzistimin e një prej shkaqeve taksative të parapara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, andaj lidhur me refuzimin e prapësimi të debitorit, në kuptim të nenit 73 të LPP-së, gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet përfaqësuesit të kreditorit në emër të përgjigjes në prapësim të ushtruar në vlerë prej EUR 78.00,

konform rregullores në fuqi për tarifat e avokatëve, nr. tarifor 6, lidhur me përmbartimet në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë deri në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 571/24, datë 20.09.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.